

10

Fillimi i shkollës, leximi dhe shkrimi

10 dhjetë keshilla për prindërit

1 Rregull bazë: Mundohuni të mos e mësoni ju vetë fëmijën tuaj.

Jepini atij shpesh mundësinë të bëhet kurioz për shkronjat që gjenden në libra, në etiketa apo tabela të ndryshme. Mbi të gjitha përkushtohuni duke dhënë informacione mbi pyetjet spontane të fëmijës dhe interesit të tij për shkrimin.

Disa keshilla konkrete:

2 Lexojini fëmijës suaj sa më shpesh të jetë e mundur.

Lejojeni fëmijen tuaj të zgjedhë vetë librat ose revistat, momentin dhe për sa kohë të dëshirojë. Në qoftë se fëmija juaj ju ndjek në librin që po lexoni, mund t' shoqëroni me gisht kalimin nga fjala në fjalë gjatë leximit. Bëni në të njëjtën kohë pushime të shkurtra gjatë te folurit, në mënyrë që fëmija të dallojë se cilat njësi leximi dhe cilat njësi shkrimi i perkasin njera tjetres.

3 Edhe kur lexoni për veten tuaj si prindër: lexojeni tekstin me zë të ulët në momentin që fëmija ndodhet pranë jush.

Shumë fëmijë nuk e dinë, se çfarë bëjnë prindërit e tyre kur lexojnë një libër ose shikojnë një gazetë. Për më tepër fëmija mund të bëhet kurioz mbi tekstin që po lexoni. Më pas mund të flisni me të mbi fotografinë që përmban artikulli në gazetë dhe në të njëjtën kohë të tregoni në tekst: «Ketu thuhet që ...». Kështu fëmija dallon ndryshimin midis vizatimit, ngjyrosjes së pikturave, leximit dhe shkrimit.

4 Komentoni aktivitetet e leximit dhe të shkrimit tuaj si prindër.

Flisni, ndërkohë që shkruani listën e blerjeve që do të bëni. Pyesni fëmijen tuaj: «Çfarë duhet të shkruaj akoma që të mos harrojmë gjë?» Lexoni në dyqan listën me zë të lartë: «Këtu kemi shkruar: *1 kilogram sheqer* – ku mund t'a gjejmë atë? Ah, këtu lexohet *sheqer!*» Flisni me zë të ulët kur kërkoni produktet e listës suaj në raftet e supermarketit: «Këtu shkruan *sheqer*, aty *kripë* – ku shkruhet *miell* përmbi pako?»

5 Lëreni fëmijen tuaj të gjejë vetë çfarë shkruhet në tabela dhe mbishkrime: Përgjatë rrugës, në reklama, mbi pako.

Tërhiqini vëmendjen mbi ngjashmerinë e fjalëve tek të cilat ai tregon interes: «E shikon: fjala *Polici* ka ngjashmëri në shkronjat e para me fjalën *Post* – dhe kur i shqiptojmë këto fjale janë të ngjashme: P-ost – P-olici»

Mos ushtroni me fëmijen tuaj alfabetin ose mënyrën e të shkruarit të fjalëve. Lejoni që ndonjëherë fëmija vetë t'ju drejtojë pyetje dhe përgjigjuni atij sipas rasteve.

6 Luani lojra gjuhësore: «Cilat fjalë tingëllojnë njësoj në fillim?» Bëni ushtrime me anë të disa shembujve: *Dielli* – *dora* – *dita* ...

Ose luani rolin e robotit: «Une jam një robot. Ai i copëton fjalët. Çfarë do të thotë ai kur flet kështu: *GJ – Y – SH – J – A?*» – «Tani flit edhe ti një herë si një robot.»

Kujdes: Mos gërmëzo fjalën por thuaj vetëm tingullin e saj.

Edhe rima dhe ushtrime të tilla si: «Unë shikoj diçka që ti nuk e shikon, kjo fjalë fillon me O», nxisin njohurinë për gjuhën. Kështu fëmija i kushton vëmendje tingullit të gjuhës, me të cilin lidh shkrimin me shkronjat.

7 Kur fëmija juaj ngjyros ose vizaton: Flisni me të për atë që ai po vizaton.

Formuloni një përshkrim të vizatimit sipas asaj që fëmija juaj ju thote. Ofrojeni atij këtë si titull për vizatimin: psh «Ah, makina po ecën shpejt – dëshiron t'a shkruaj këtë?» Flisni ngadalë ndërkohë që shkruani, në mënyrë që fëmija juaj të kuptojë, se si gjuha e folur kthehet në atë të shkruar.

Pyeteni rastësisht ndërkohë që vizaton një pikturë: «Dëshiron të shkruaj edhe emrin tënd?» Rekomandohet të shkruani me shkronja shtypi me madhësi, nga 1 deri në 3 cm.

8 Krijoni me fëmijën tuaj, libra, fletore të vogla ose vizatime të përmasave të mëdha.

Ndihmoni fëmijën sipas dëshires se tij, të presë e të ngjise vetë figura të ilustruara, të vizatojë dhe të kopjojë nga një tekst, apo fjalë të ndryshme ... Ofrojeni atij ndihmën tuaj si sekretare/ sekretar: «Do që të shkruaj ...?»

Krijoni një kutizë të bukur, për fjalët e tij të reja, të cilat ju herë pas here ja dhuroni në letra të vogla, dhe në këtë mënyrë ka mundësi t'i perserisë ato.

9 Pranoni shkarravina dhe prova të tjera shkrimi të fëmijes tuaj.

Merreni seriozisht çfare ju tregon fëmija juaj për këtë.

Gabimet nuk janë të rënda, pasi nga gabimet mësohet. Edhe gjuhën e folur fëmija e ka mësuar duke bërë gabime, të cilat i ka përmirësuar më vonë. Pranoni mënyrën e te shkruarit të fëmijës tuaj si nivel të performancës. Më tej, si krahasim mund t'i tregoni në shkollë, si shkruajnë të rriturit. Shkruani më parë ju dhe më pas fëmija, fjalë që ai ka dëshirë t'i mësojë.

10 Nxitni rrethin tuaj familjar ose të miqve, që t'i shkruajnë fëmijës tuaj letra dhe e-maile.

Ofrojin fëmijës tuaj mundësinë që të shkruajë një përgjigje ndaj letrës që ka marrë nga dikush. Lexoni herë pas here pjesët e para dhe në fund të gjithë letrën që keni shkruar: «Atëherë tani kemi shkruar ...»

Brügelmann, H./Brinkmann, E. (1998): *Die Schrift erfinden – Beobachtungshilfen und methodische Ideen für einen offenen Anfangsunterricht im Lesen und Schreiben*. Libelle: CH-Lengwil (2. Aufl. 2005)
Brügelmann, H. (Hrsg.) (1998): *Kinder lernen anders: vor der Schule – in der Schule*. Libelle: CH-Lengwil (2. Aufl. 2000)

